

## Bursa ndërkombëtare për stazhe në parlament

**Angazhoheni në jetën sociale, akademike apo politike të vendit tuaj? Dëshironi të merrni pjesë në mënyrë aktive dhe plot përgjegjësi në ndërtimin e së ardhmes së vendit tuaj? Keni dëshirë të vështroni mbrapa „kulisave“ të politikës dhe të përjetoni nga afër demokracinë?**

Atëherë shfrytëzoni mundësinë për të marrë pjesë në programin e vetëm mbarëbotëror të Bundestagut Gjerman dhe të universiteteve të Berlinit dhe aplikoni për një bursë ndërkombëtare për stazhe në parlament (IPS).

Bundestagu Gjerman në bashkëpunim me universitetet e Berlinit u ofron çdo vit afërsisht 115 njerëzve të rinj të kualifikuar nga deri tani 25 vende mundësinë e vetme në botë për të kryer një praktikë disa-mujore pranë një deputeteje apo deputeti të Bundestagut Gjerman, dhe të njohin kështu procese vendimmarrëse të politikës gjermane dhe të mbledhin përvoja praktike në fushën e punës parlamentare.

Qëllimi i programit është të rrisë interesin e njerëzve të rinj për demokracinë dhe shoqërinë, të inkurajojë pjesëmarrjen e tyre në jetën demokratike dhe t'i entuziasmojë ata për këtë gjë. Bursa ndërkombëtare për stazhe në parlament (IPS) është një investim afatgjatë në forcimin e vlerave demokratike dhe të tolerancës, dhe një nxitje për lirinë kulturore dhe bashkëjetesën paqësore në Evropë.

Vendet pjesëmarrëse aktualisht janë: Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Çekia, Estonia, Franca, Gjeorgjia, Hungaria, Kazakistani, Kroacia, Letonia, Lituania, Maqedonia, Moldavia, Polonia, Rumania, Rusia, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Ukraina.

Programi IPS fillon më 1 mars dhe zgjat gjithsej 5 muaj. Pjesa thelbësore e programit është një stazh prej tre muajsh e gjysmë në zyrën e një deputeteje/deputeti të Bundestagut. Përveç kësaj bursistët ndjekin seminare pranë pesë fondacioneve politike dhe kryejnë një program shoqëruar akademik të organizuar nga tre universitetet e Berlinit.

Pjesëmarrëset dhe pjesëmarrësit marrin nga fondet e Bundestagut Gjerman një bursë mujore prej 450,- € . Bursa përfshin dhe strehimin në një apartament tredhomësh, në të cilin banojnë nga dy bursiste/bursistë, si edhe marrjen përsipër të shpenzimeve për sigurimin shëndetësor, sigurimin në rast aksidenti dhe sigurimin e përgjegjësive (sigurime për studentë). Pjesëmarrësve u rimbursohen shpenzimet e udhëtimit për në Berlin dhe të kthimit nga Berlini.

Informacione të mëtejshme mbi programin IPS dhe për aplikimin mund t'i gjeni në internet nën adresën: [www.bundestag.de/ips](http://www.bundestag.de/ips)

Ne ju ftojmë përzemërsisht të merrni pjesë në programin IPS dhe gëzohemi për aplikimin tuaj.